



Biografi e shkurtër

Ornela Ismalaja, Këshilltare Ekonomike

Ornela Ismalaja u diplomua në vitin 2003 në degën Finance-Kontabilitet në fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2011 përfundoi studimet Master në Administrim Biznes (MBA), në UBIS University, Gjeneve, në bashkëpunim me Institucionin e Arsimit të Lartë ISSAT.

Ka një përvojë pune në sektorin financiar dhe mikrofinanciar për rreth 16 vjet, në banka të nivelit të dytë si banka Raiffeisen Bank, NBG Albania SHA, American Bank of Investment (ABI Bank) dhe Kredo Finance.

Në periudhën korrik 2004 - mars 2006 ka punuar në Raiffeisen Bank si Specialiste e Shërbimeve bankare dhe kredidhënies.

Në mars 2006 iu bashkua Bankës NBG Albania SH.A.,(nga Tetor 2018 ABI Bank) ku vazhdoi deri në nëntor 2019. Gjatë kësaj periudhe ka punuar në pozicione të ndryshme, në departamente të ndryshme, si më poshtë:

Gjatë periudhës mars 2006 – mars 2010 ka mbajtur pozicionin Përgjegjëse e Operacioneve, e më pas Përgjegjëse e Shitjeve të Produkteve për Individë, në një nga degët e bankës.

Gjatë periudhës prill 2010 – nëntor 2019 ka punuar si Oficere e Rikuperimit të Kredive Korporative në Vonesë, pranë Divizionit të Riskut; Oficere e Pajtueshmërisë, pranë Divizionit të Pajtueshmërisë; Përgjegjëse e Departamentit të Shërbimeve të Burimeve Njerëzore, pranë Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Gjatë periudhës dhjetor 2019 – janar 2022 ka punuar si konsulente financiare pranë Fondacionit “SIG” dhe gjatë periudhës shkurt 2022 – dhjetor 2022 ka punuar në institucionin mikrofinanciar Kredo Finance, pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Administratës.

Është çertifikuar si Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe si Vlerësuese e Pasurive të Paluajtshme. Gjatë eksperiencës së saj të punës ka kryer një sërë trajnimesh me ekspertë vendas dhe të huaj për konsulencë biznesi, pastrimin e parave dhe mbrojtjen e të dhënave personale, menaxhimin financiar, etj.

Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

Nga janari i vitit 2023, është pjesë e strukturës së Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me detyrën këshilltare ekonomike.